

VENDIM
Nr.1125, datë 13.11.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.954, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, STRUKTURËN, FUNKSIONIMIN E QENDRËS
NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE (QNOD) DHE
BASHKËVEPRIMIN ME INSTITUCIONET SHTETËRORE, QË KANË INTERESA NË
DET”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 3, pika 3, e 4/1, pika 3 të ligjit nr.8875, datë 4.4.2002 “Për rojën bregdetare shqiptare”, të ndryshuar, dhe të neneve 6, 29 e 41 të ligjit nr.9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun III të vendimit nr.954, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Shkronja “b” shfuqizohet.
- b) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:
“ç) Oficerët e shërbimit/Oficerë civilë turni;”.
- c) Shkronja “d” shfuqizohet.

2. Paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të pikës 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“- Koordinatorët institucionalë janë përfaqësues të caktuar nga institucionet shtetërore, që marrin pjesë në QNOD, dhe i përfaqësojnë ato gjatë planifikimit të përditshëm dhe afatgjatë operacional. Koordinatorët e caktuar nga institucionet pjesëmarrëse janë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planeve operacionale të QNOD-së, të miratuara bashkërisht, për vlerësimet e riskut, rekomandimet e trajnimit e të planit, sipas vendimeve përkatëse. Çdo institucion pjesëmarrës vendos sipas nevojave për numrin e koordinatorëve në QNOD.

- Oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit janë oficerët përgjegjës për personelin, që shërben në sallën operacionale të QNOD-së. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave do të kenë oficerë shërbimi, 24 orë, për marrjen e vendimeve në QNOD. Secili oficer shërbimi është përgjegjës për drejtimin e operacioneve, kompetencë e ministrisë që përfaqëson. Për sigurimin e kontrollit civil për të gjitha operacionet policore, oficeri i shërbimit, i caktuar nga Ministria e Brendshme në sallën operative të QNOD-së, do të marrë përsipër dhe do të ekzekutojë operacione, që lidhen me detyrat e policisë. Përgjegjësitë dhe bashkërendimi i oficerëve të shërbimit përshkruhen në procedurat operacionale, të miratuara.

- Personeli i operacioneve dhe ai i shërbimit të QNOD-së caktohen nga Ministria e Mbrojtjes dhe do të jenë operatorë të trajnuar radarësh dhe/ose personel për ndërlidhje. Personeli i shërbimit të QNOD-së do të shërbejë me turne shërbimi, për të garantuar se personeli është operativ çdo ditë, gjatë të gjithë ditës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha